# DËSHMI ARKIVI

**A-467139**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | I moshuari gjendet pa ndjenja në mes të rrugës, dëshmitari: Ambulanca u vonua! |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1393950.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 24 shtator 2026, 19:26:47 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 24 shtator 2026, 19:20:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 24 shtator 2026, 19:19:00 UTC → 24 shtator 2026, 19:21:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d574fc1bf2d55550d6ef1fcfcb353e9403308f12ccca33639036fa7e64758b2b` |
| TEKSTI | `4419faaaff18a87f9b58db5ba62f0216fb292fc086e2b1a2463c794f57244c69` |
| PAMJA | `32fecd7fab490d7cd905289db07dc795df4e3babc879e6cd2ad1f5c510b99200` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ee907ec9da0e1cfd4809faa1c8f1ec36eb38a4d2917af4dc390f71e3b3431503` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `c406e3f4a37e76aa776ac36276272ef42aa1461296b5cb3dea2e85e36f4d98cc` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ee907ec9da0e1cfd4809faa1c8f1ec36eb38a4d2917af4dc390f71e3b3431503`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# I moshuari gjendet pa ndjenja në mes të rrugës, dëshmitari: Ambulanca u vonua!

Shkruar nga: V Gashi | Publikuar më: 24.09.2026, 21:20

Share Share



Një person i moshuar është gjetur mbrëmjen e sotme i shtrirë në mes të rrugës, pranë rrethrrotullimit të luleve në Elbasan.

Pamjet e mbërritura në redaksinë e JOQ Albania tregojnë të moshuarin të shtrirë në rrugë, ndërsa qytetarët kanë kërkuar ndihmë mjekësore.

Sipas dëshmitarit që ndodhej në vendngjarje, bëhet fjalë për një person rreth 65-70 vjeç, i cili ishte në gjendje të rëndë dhe nuk lëvizte, ndërsa sipas tij kishte puls dhe merrte frymë.

Dëshmitari thotë se nuk e ka parë momentin se çfarë i kishte ndodhur të moshuarit, ndaj nuk dihet nëse ai është përfshirë në një aksident rrugor apo është ndier keq dhe ka humbur ndjenjat.

Ajo që ngre shqetësim është koha e mbërritjes së ambulancës. Dëshmitari pretendon se urgjenca e Elbasanit u njoftua menjëherë, por ambulanca është vonuar për më shumë se 20 minuta.

“Dëshmitarët telefonuan ambulancën, pritën që të vinte”, shkruhet në mesazhin e dërguar bashkë me pamjet, ndërsa dëshmitari shton se disa prej personave të pranishëm u larguan pasi pritën për një kohë të gjatë.

Sipas tij, nga spitali deri në vendngjarje janë rreth 5 minuta rrugë.

Deri në këto momente nuk ka një njoftim zyrtar nga Policia apo autoritetet shëndetësore për rrethanat e ngjarjes dhe gjendjen e të moshuarit.

View this post on Instagram



Më të Lexuarat

ARTIKULL JOETIK?



A post shared by JOQ Albania (@joqalbania)

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME

**Më të fundit**

Dërgo materialin tënd këtu ›

Puno me ne! Marketing Politika e privatësisë Rreth Nesh Kushtet e përdorimit Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.